

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

Neni 1

Neni 30 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 30
Parapagimet**

1. Gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore, këstet tremujore të tatimit mbi fitimin, brenda datës 30 mars, për muajt janar, shkurt dhe mars; brenda datës 30 qershor, për muajt prill, maj dhe qershor; brenda datës 30 shtator, për muajt korrik, gusht dhe shtator dhe, brenda datës 30 dhjetor, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor. Këstet mund të paguhen edhe në baza mujore, jo më vonë se data 15 e çdo muaji, në shumatat si më poshtë:

a) për çdonjërin nga muajt janar, shkurt dhe mars të periudhës vijuese tatimore, shumën e tatimit mbi fitimin për periudhën tatimore të dy viteve më parë pjesëtuar me 12;

b) për çdonjërin nga 9 muajt e tjerë të periudhës vijuese tatimore, shumën e tatimit mbi fitimin për periudhën paraardhëse tatimore pjesëtuar me 12.

2. Në rastin kur tatimpaguesi e fillon veprimtarinë gjatë periudhës tatimore të vitit të dytë paraardhës, parapagimet për muajt janar-mars të periudhës vijuese tatimore janë si më poshtë:

2.1.Shuma e tatimit mbi fitimin për periudhën tatimore të dy viteve më parë pjesëtuar me numrin e muajve, gjatë të cilëve tatimpaguesi ka ushtruar veprimtarinë tatimore. Për përcaktimin e parapagimeve për muajt e tjerë të periudhës vijuese tatimore, tatimi llogaritet sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni.

3. Në rastin kur tatimpaguesi e fillon veprimtarinë gjatë periudhës paraardhëse tatimore, parapagimet për muajt janar-mars të periudhës vijuese tatimore janë sa shuma e vlerësuar e tatimit mbi fitimin për periudhën e mëparshme, pjesëtuar me numrin e muajve të periudhës së mëparshme, gjatë të cilëve është ushtruar veprimtari. Shkronja “b”, e pikës 1, të këtij neni, zbatohet për përcaktimin e parapagimeve për efekt të muajve të mbetur nga periudha vijuese tatimore.

4.Në rastin kur një tatimpagues fillon të ushtrojë një veprimtari në periudhën vijuese tatimore, parapagimet për këtë periudhë janë sa shuma e vlerësuar e tatimit mbi fitimin për periudhën vijuese, pjesëtuar me numrin e muajve të mbetur nga periudha vijuese tatimore.

Përfundimisht, tatimpaguesit që fillojnë veprimtarinë në periudhën vijuese dhe ushtrojnë veprimtari në sferën prodhuese nuk do t'i nënshtrohen parapagimit të detyrimit për tatimin mbi fitimin për një periudhë 6-mujore ose për periudhën e mbetur deri në fund të vitit vijues, nëse kjo periudhë është edhe më e vogël se 6 muaj.

5.Në rastin kur tatimpaguesi, në çdo kohë, gjatë periudhës tatimore, vërteton para organeve tatimore se tatimi mbi fitimin për këtë periudhë tatimore do të jetë, në mënyrë domethënëse, më i ulët se tatimi mbi fitimin në periudhën paraardhëse ose periudhën e dytë paraardhëse, atëherë organet tatimore pranojnë zvogëlimin e parapagimeve, sipas rregullave të vendosura me udhëzim të Ministrit të Financave. Në rast se subjekti taksapagues ka ulur këstet e parapagimit, të caktuara nga organi tatimor, dhe detyrimi tatimor vjetor për tatimfitimin, që rezulton nga bilanci, tejkalon parapagimin me më shumë se 10 për qind, subjekti duhet të paguajë kamatëvonesa mbi diferencën ndërmjet detyrimit real vjetor dhe shumës së parapaguar gjatë vitit, sipas rregullave të vendosura me udhëzim të Ministrit të Financave.

6.Nëse organet tatimore vlerësojnë se tatimi mbi fitimin për periudhën vijuese tatimore do të tejkalojë me më tepër se 10 për qind tatimin mbi fitimin e periudhës së mëparshme tatimore, ato mund të rregullojnë në rritje parapagimet, në përputhje me tatimin mbi fitimin e vlerësuar prej tyre.”.

Neni 2

Në nenin 33/1, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Personi juridik duhet të deklarojë dhe të paguajë për llogari të administratës tatimore tatimin mbi dividendin e pagueshëm, sipas pikës 1, të këtij neni, jo më vonë se data 20 gusht e vitit kur bëhet miratimi i rezultateve, pavarësisht nëse është bërë ose jo shpërndarja e dividendit.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.7.2014

Shpallur me dekretin nr. 8664, datë 1.8.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Botuar ne F.Zyrtare 126 / 2014

Dale nga shtypi me 11.08.2014